



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

GJENDJA NË ZBATIMIN E MARRËVESHJEVE TË BRUKSELIT

**RAPORT I DORËZUAR NË BASHKIMIN EVROPIAN/SHËRBIMIN EVROPIAN PËR VEPRIM TË
JASHTËM**

NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Prishtinë, 16 janar 2014

Shënim: versioni origjinal i këtij dokumenti është në gjuhën angleze

Parathënie

Ky raport është nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe paraqet gjendjen gjithëpërfshirëse të zbatimit të të gjitha marrëveshjeve të Brukselit. Raporti përfshin Marrëveshjen e Brukselit, të datës 19 prill 2013 dhe Planin e Zbatimit, të datës 22 maj 2013 si dhe marrëveshjet e arritura në Dialogun Teknik që nga marsi i vitit 2011. Ai mbulon periudhën nga 1 janari 2013 deri më 15 janar 2014.

Raporti tregon se sa është arritur gjatë vitit të kaluar dhe çfarë mbetet për të bërë në të ardhmen.

Qeveria e Kosovës konsideron se është arritur përparim i mirë në disa çështje të rëndësishme, përderisa në disa të tjera janë arritur nivele të ndryshme të përparimit. Po ashtu ekzistojnë çështje për të cilat ende nuk ka filluar zbatimi.

Ne besojmë se përparimi i vërtetë i dialogut mbetet zbatimi i plotë i marrëveshjeve dhe në këtë aspekt Republika e Kosovës është dëshmuar konstruktive dhe efektive në arritjen dhe zbatimin e marrëveshjeve.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e këtij procesi, përparimi i bërë vë themelet për zbatimin koherent dhe të plotë të Marrëveshjeve të Brukselit.

Puna efektive në të ardhmen është e domosdoshme për të përmbushur qëllimet e këtij dialogu të rëndësishëm për paqe mes dy shteteve që aspirojnë Bashkimin European, Kosovës dhe Serbisë, e cila nëse kryhet me sukses dhe në mënyrë efikase mund të shërbejë si model pozitiv për çështjet e tjera të hapura në raportet mes vendeve në rajon dhe më gjerë.



Edita Tahiri

Zëvendëskryeministre

Shefe e Delegacionit të Republikës së Kosovës

në dialogun për zbatim të marrëveshjeve të Brukselit

Përmbajtja

Hyrje	4
1. Zgjedhjet lokale në Kosovë, inaugurimi dhe funksionimi i autoriteteve të reja komunale	7
2. Siguria	8
3. Drejtësia	12
4. Ligji për amnistinë	15
5. Mbledhja e të hyrave doganore	16
6. Fondi zhvillimor	17
7. Asociacioni	18
8. Zyrat ndërlidhëse	18
9. IBM	21
10. Liria e lëvizjes	25
11. Tregtia e lirë	25
12. Bashkëpunimi rajonal	26
13. Energjia	27
14. Telekomunikacioni	28
15. Regjistri civil	28
16. Kadastra	29
17. Diplomat universitare	29
Përfundimi	30
Lista e shkurtesave	31

Dialogu në Bruksel për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, i lehtësuar nga Bashkimi Evropian, ka arritur përparim të dukshëm me negocimin dhe nënshkrimin e një Marrëveshjeje historike të 19 prillit 2013, nga Kryeministrat e të dy shteteve dhe nga Përfaqësuesja e Lartë e BE-së, Catherine Ashton.

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kryeministri Hashim Thaçi kanë qenë plotësisht të përkushtuar ndaj dialogut të Brukselit dhe rezultateve të tij, me qëllim të avancimit të vizionit tonë për një shtet evropian dhe euro-atlantik dhe për të ndihmuar forcimin e mëtejshëm të paqes dhe stabilitetit në rajon përmes marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe bashkëpunimit rajonal.

Ne mbesim të përkushtuar ndaj zbatimit efektiv të Marrëveshjes së Brukselit, të datës 19 prill 2013, e cila është në përputhje me caqet kyçe të normalizimit të marrëdhënieve mes dy shteteve që aspirojnë BE-në, Kosovës dhe Serbisë, normalizimit të gjendjes në pjesën veriore të Kosovës përmes integritetit të qytetarëve serbë të asaj pjese në institucionet e Kosovës, duke shpërbërë strukturat ilegale serbe që operojnë në Kosovë që nga viti 1999 dhe duke avancuar integritetin evropian për të dy shtetet.

Republika e Kosovës, si një shtet i pavarur dhe sovran, është faktor i paqes dhe stabilitetit në rajon dhe ne do të bëjmë çdo përpjekje për të brumosur edhe më tej këto vlera. Ne jemi të përkushtuar të shikojmë kah e ardhmja duke mos e harruar të kaluarën, të ndërtojmë një të ardhme më të mirë për shtetin tonë dhe të gjithë qytetarët dhe për të forcuar marrëdhëniet tona me partnerët tanë strategjikë, Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, të cilët janë bashkë me ne në këtë rrugëtim.

Për këtë qëllim dhe duke pasur parasysh gjendjen aktuale të zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit, Qeveria e Republikës së Kosovës konsideron se është arritur përparim i konsiderueshëm në zbatimin praktik, gjë që vë themelet për një zbatim të besueshëm dhe të plotë të Marrëveshjeve të Brukselit. Megjithatë, disa çështje të rëndësishme ende kërkojnë zgjidhje, gjë që do të siguronte një bazë të qëndrueshme për arritjen e qëllimeve të mësipërme të dialogut të Brukselit.

Të arriturat kryesore në procesin e zbatimit janë si më poshtë:

Përparim i mirë është arritur në këto fusha: mbajtjen e suksesshëm të zgjedhjeve komunale në Kosovë më 3 nëntor 2013, me pjesëmarrjen, për herë të parë, të qytetarëve të katër komunave veriore, që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës; inaugurimin zyrtar të të gjitha autoriteteve të reja komunale dhe në veçanti të komunave veriore në përputhje me ligjet e Kosovës dhe Marrëveshjen e Brukselit, me përjashtim të kryetarit të Mitrovicës veriore ku do të mbahen zgjedhjet e reja; zbatimin e Marrëveshjes për mbledhjen e të hyrave doganore në pikat kufitare veriore më 14 dhjetor 2013; ratifikimin e Ligjit për Amnistinë nga Kosova më 17 shtator 2013; themelimin e Fondit Zhvillimor dhe Bordin Menaxhues të tij nga Kosova (respektivisht në

shtator të vitit 2013 dhe më 13 dhjetor 2013); dhe hapjen e zyrave ndërlidhëse në të dy zyrat (17 qershor 2013).

Përparim i kufizuar është bërë në këto fusha: siguri, përparimi përfshinë emërimin e një ushtruesi të detyrës së drejtorit rajonal të policisë dhe themelimin e një drejtorie për rajonin e Mitrovicës nga Kosova, mbylljen e zyrave të MUP-it nga Serbia dhe përparimin e kufizuar në integrimin e policisë serbe në policinë e Kosovës. Përkitazi me çështje të drejtësisë, është bërë përparim më i madh në planifikimin e zbatimit më shumë se në praktikë, me përjashtim që gjykatat paralele serbe kanë ndërprerë pranimin e rasteve të reja në afatin për të cilin është arritur marrëveshja, nuk është bërë përparim për integrimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë në institucionet gjyqësore të Kosovës, në dhjetor u bë një përparim i rëndësishëm në çështjen e strukturës, ku, në bazë të legjislacionit të Kosovës dhe sistemit unik të drejtësisë, do të ketë një Gjykatë Themelore dhe një Zyrë për Prokurorinë Themelore për rajonin e Mitrovicës, megjithatë ekzistojnë ende disa dallime të cilat duhet të tejkalohen. Për telekomunikacionin dhe energjinë po ashtu janë arritur marrëveshje më 8 shtator 2013 dhe negociatat për zbatimin e marrëveshjes për energji janë duke vazhduar përderisa zbatimi i marrëveshjes për telekomunikacionin nuk ka filluar ende më 15 janar 2014, me gjithë kërkesat e vazhdueshme nga ana jonë që BE duhet ta nisë atë pa vonesë.

Çështjet në të cilat pritet përparim:

1. Nuk ka pasur përparim në mbylljen e strukturave të ashtuquajtura të “mbrojtjes civile”, një lloj i strukturës paramilitare serbe që ka vepruar në Kosovë që nga fundi i luftës në vitin 1999. Me gjithë thirrjet nga Marrëveshja e Brukselit për mbyllje të të gjitha strukturave paralele dhe kërkesave të vazhdueshme nga pala kosovare për ta trajtuar çështjen, pala serbe ka refuzuar çdo diskutim në lidhje me të. Pala serbe pretendon se ata nuk mund të futen në diskutime në këtë çështje pasi që kjo çështje është krijim i komunave veriore të Kosovës. Këto pretendime janë minuar kur pala kosovare paraqiti më 17 korrik 2013 argumente ligjore se strukturat e ‘mbrojtjes civile’ ishin themeluar nga Ministria e Mbrojtjes e Serbisë në bazë të Ligjit të Mbrojtjes. Megjithatë, lehtësuesit e BE-së nuk kanë mundur ta bindin palën serbe për t’u futur në diskutime për këtë çështje deri në takimin e fundit të mbajtur në dhjetor, në nivel të kryeministrave dhe Përfaqësueses së Lartë Ashton në dhjetor 2013, ku BE-ja prezantoi një projekt propozim për të zgjidhur këtë problem, i cili mbetet të trajtohet në fazën e ardhshme të dialogut.

2. Integrimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë në institucionet kosovare të drejtësisë nuk ka filluar ende. Një marrëveshje e arritur për një gjykatë themelore dhe një zyrë të prokurorisë themelore në rajonin e Mitrovicës si pjesë e sistemit unik të institucioneve kosovare të drejtësisë (në dhjetor të vitit 2013) ka hapur perspektivën për procesin e integritimit. Ndonëse, përparimi i mëtejshëm po pengohet nga logjika etnike e atyre gjykatave të cilat i kërkon Serbia. Qeveria e Kosovës konsideron se drejtësia si vlerë universale nuk mund të ndahet nga asnjë vijë etnike dhe se vlerat e tilla janë në thelb të Kushtetutës së shtetit të Kosovës.

Qeveria e Kosovës beson fuqishëm se përparim më i madh në thelb do të mund të arrihej për zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit, po të kishte konsistencë të mjaftueshme nga pala e Serbisë në zbatimin e asaj për çfarë është arritur marrëveshja. Në një varg takimesh me zyrtarët e BE-së, ne kemi ngritur shqetësimet rreth tendencave të Serbisë për t'iu shmangur ose për ta vonuar zbatimin e marrëveshjeve. Veç kësaj, pretendimet e hapura të Serbisë në lidhje me të ashtuquajturin 'neutralitet ndaj statusit' të Marrëveshjes së Brukselit, me gjithë faktin se Marrëveshja e Brukselit e bën të qartë se ligjet e Kosovës zbatohen në procesin e integritimit, paraqesin sfida ndaj procesit të përgjithshëm dhe caqeve reale të këtij dialogu.

Siç është thënë pareshtur, Qeveria e Kosovës thekson prapë se qartësia e Marrëveshjes së Brukselit duhet të vërtetohet prapë nga Bashkimi Evropian si lehtësues dhe garantues të këtij projekti paqësor dhe vizionar për një të ardhme më të mirë dhe për marrëdhënie të mira fqinjësore mes Kosovës dhe Serbisë dhe tërë rajonit.

Raporti në vazhdim paraqet pasqyrën e gjendjes aktuale në zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit të datës 19 prill 2013 dhe Planin e Zbatimit të arritur më 22 maj 2013. Ai po ashtu përfshin marrëveshjet e arritura në dialogun Teknik që nga marsi i vitit 2011. Ai mbulon periudhën mes 1 janarit 2013 dhe 15 janarit 2014.

1. ZGJEDHJET LOKALE NË KOSOVË, INAUGURIMI DHE FUNKSIONIMI I AUTORITETEVE TË REJA KOMUNALE

Suksesi i zgjedhjeve lokale (3 nëntor – 1 dhjetor 2013) dhe inaugurimi i organeve të sapozgjedhura në të gjitha komunat në Kosovë shënon një hap të rëndësishëm për Kosovën dhe zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit. Suksesi i veçantë i lidhet me faktin se për herë të parë pas pavarësisë së Kosovës (në vitin 2008), këto zgjedhje u mbajtën në mbarë Kosovën, përfshirë edhe katër komunat veriore me shumicë serbe, në përputhje me ligjet e Kosovës dhe në përputhje me Marrëveshjen e Brukselit. (Para vitit 2008, zgjedhjet u mbajtën dy herë në mbarë Kosovën, përfshirë edhe komunat veriore).

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) i Kosovës organizoi dhe certifikoi zgjedhjet dhe OSBE-ja ofroi lehtësim për komunat veriore. Legjitimiteti ndërkombëtar i këtyre zgjedhjeve është vërtetuar nga aktorë ndërkombëtarë, përfshirë Misionin Vëzhgues të BE-së. Dalja në zgjedhje në komunat veriore ishte relativisht e mirë, duke pasur parasysh tranzicionin politik nga bojkotimi në pjesëmarrje në zgjedhjet e mëhershme nga qytetarët serbë në veri, falë Marrëveshjes së Brukselit. Është e rëndësishme të theksohet se për herë të parë, subjektet politike dhe pjesëmarrësit në zgjedhje komunale në këtë pjesë të vendit ishin regjistruar dhe certifikuar nga KQZ-ja. Veç kësaj, certifikimi i listës së votuesve ishte kryer me sukses dhe në mënyrën e duhur nga Agjencia Kosovare e Regjistrimit Civil, me gjithë vonesat e shkaktuara nga pala serbe për lejimin e qasjes në librat e regjistrimit civil të komunave veriore, të cilat ende nuk janë kthyer nga Serbia në Kosovë. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa po ashtu ka qenë efektiv në adresimin e çfarëdo ankese që ka pranuar. Ka pasur disa incidente të dhunshme që kanë ndodhur në veri të Mitrovicës të përcjella nga paraqitja e disa paramilitarëve me uniformë të strukturës “Mbrojtja Civile” rreth disa vendvotimeve, gjë që nuk ia doli të minojë procesin.

1.1. Inaugurimi dhe funksionimi i komunave me shumicë serbe në Kosovën veriore

Takimet inauguruese janë përfunduar në të gjitha komunat në Kosovë. Një përparim kyç është arritur me inaugurimet e suksesshme në katër komunat veriore në përputhje me ligjet e Kosovës dhe Marrëveshjen e Brukselit, ku roli i BE-së ishte jetik. Zgjedhjet për kryetarin e Mitrovicës së veriut do të organizohen prapë, pasi që kryetari i zgjedhur ka dështuar të bëjë betimin. Procesi i inaugurimit në katër komunat veriore ka kërkuar bashkëpunim intensiv mes Qeverisë së Kosovës, BE-së dhe përfaqësuesve të këtyre komunave me qëllim që të sigurohej përputhja me ligjet e Kosovës, që doli me sukses. Autoritetet komunale të zgjedhura në mënyrë demokratike do t’iu shërbejnë komuniteteve lokale në pajtim me ligjet e Kosovës dhe brenda kornizës institucionale të Kosovës.

2. SIGURIA

Sa i përket çështjeve të sigurisë, Marrëveshja e Brukselit fton për shpërbërjen e të gjitha strukturave paralele të sigurisë të Serbisë dhe integrimin e individëve serbë në policinë e Kosovës dhe në strukturat e tjera ekuivalente të sigurisë në Kosovë (nenet 7 dhe 8) dhe emërimin e një Komandanti Rajonal të Policisë për katër komunat veriore me shumicë serbe (neni 9).

Afati i fundit për të cilin është arritur pajtimi për procesin e integritit dhe shpërbërjes në fushën e sigurisë ishte 30 shtatori 2013 (Përfundimet e Kryesuesit të GP për Polici, 05-06 qershor 2013). Deri më sot, është bërë pak përparim në të dy proceset, në lidhje me fushëveprimin dhe afatet kohore. Përparimi i plotë është bërë në Nenin 9, respektivisht në emërimin e një ushtruesi të detyrës së Komandantit Rajonal të Policisë dhe themelimin e një drejtorie rajonale nga Kosova sipas afateve kohore nga marrëveshja.

2.1. Një drejtor dhe drejtori rajonale

Ushtruesi i detyrës së Drejtorit Rajonal për katër komunat veriore është emëruar nga Kosova më 25 qershor 2013

Korniza ligjore/udhëzimi administrativ për themelimin e Drejtorisë Rajonale të Policisë është miratuar nga Kosova më 22 korrik 2013

Drejtoria Rajonale është themeluar, përfshirë stafin dhe objektet, në përputhje me Ligjin e Kosovës për Policinë dhe vendimet përkatëse administrative.

2.2. Shpërbërja e të gjitha strukturave serbe të sigurisë

2.2.1 Shpërbërja e policisë paralele serbe

Që nga 5 korriku i vitit 2013, zyrat e MUP-it janë mbyllur gradualisht nga Serbia. EULEX-ia ka verifikuar përputhshmërinë me marrëveshjen gjatë mbylljes.

Pagesa e pagave të policisë paralele ende nuk është ndërprerë nga Serbia, ndonëse fundi i afatit të parë ishte 17 qershori dhe i afatit të dytë ishte 31 dhjetori. Pas 14 qershorit, pala serbe informoi për vendimin e saj për të ndërprerë pagesën e pjesëtarëve të MUP-it, ndonëse nuk iu përmbajt aktit të vendimit, përkundër marrëveshjes për ndarjen e ndërsjellë të vendimeve nga qeveritë përkatëse për zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit (*Më 1 dhjetor, gjatë rrethit të dytë të zgjedhjeve, Policia e Kosovës arrestoi një oficer të MUP-it i cili bartte një dokument identifikues të MUP-it. Kjo tregon se elementet e MUP-it ende veprojnë*). Pala kosovare konsideron se

vendimet e Serbisë për mbylljen e objekteve të MUP-it dhe ndërprerjen e pagesave për personalin e MUP-it duhet të vërtetohen me rregullore ligjore (do të thotë me Udhëzim Administrativ).

2.2.2. Shpërbërja e strukturës paramilitare 'Mbrojtja Civile'

Nuk është bërë përparim për shpërbërjen e të ashtuquajturës 'mbrojtja civile', një lloj strukture paralele serbe e cila operon në veri të Kosovës. Pala serbe ka refuzuar përpjekjet e vazhdueshme nga pala e Kosovës për të ngritur dhe për të zgjidhur këtë çështje.

Në takimin e datës 5-6 qershor 2013, Kosova ngriti çështjen e shpërbërjes së "Mbrojtjes Civile" (MC), një strukturë paramilitare serbe që vepron në Kosovë që nga përfundimi i luftës në vitin 1999, me emra të ndryshëm.

Qëndrimi i Kosovës është se MC është një strukturë paralele e sigurisë e cila duhet të diskutohet brenda kornizës së GP për policinë, në përputhje me Planin e Zbatimit dhe Nenin 8 të Marrëveshjes së parë. Qëndrimi i Serbisë është se MC nuk është një strukturë e sigurisë dhe se as një institucion në Serbi nuk është pjesë e zinxhirit të saj komandues. Ata pretendojnë se MC është themeluar nga strukturat komunale në Kosovën veriore. Kryesuesja e BE-së ka shprehur përshtypjen se MC është një çështje për diskutim e palëve. (Shih Përfundimet nga GP për Sigurinë të mbajtur më 5-6 qershor 2013)

Më 17 korrik 2013, Kosova paraqiti argumentet ligjore se strukturat e 'mbrojtjes civile' ishin themeluar nga Ministria e Mbrojtjes e Serbisë në bazë të Ligjit të tyre të Mbrojtjes duke theksuar nenet në vazhdim:

Në Ligjin për Mbrojtje të Serbisë ("Gazeta Zyrtare e RS" Nr. 116/07), Neni 4, Paragrafi 4 është ndryshuar si në vazhdim:

"4) Mbrojtja civile është pjesë e një sistemi të integruar të policisë, e organizuar për funksionimin e suksesshëm të organeve shtetërore, organeve të krahinës autonome dhe vetëqeverisjes lokale, kompanive dhe entiteteve të tjera ligjore për mbrojtje dhe shpëtim dhe ofron kushte për jetë dhe punë të qytetarëve dhe i përmbush nevojat e forcave të mbrojtjes gjatë emergjencave dhe në luftë, "

4a) Mbrojtja civile është një sistem i organizuar, aktiviteti kryesor i së cilës është mbrojtja, rigjenerimi dhe eliminimi i pasojave të fatkeqësive natyrore, fatkeqësive teknologjike dhe shumë rreziqeve të tjera të cilat do të mund të rrezikojnë njerëzit, burimet materiale dhe kulturore dhe mjedisin në kohë paqeje dhe raste emergjente dhe luftë."

Sidoqoftë, lehtësuesit e BE-së nuk kanë mundur të bindin palën serbe të fillojë diskutimet në këtë çështje. Strukturat e 'Mbrojtjes civile' ende vazhdojnë të operojnë ilegalisht në pjesën veriore të Kosovës dhe janë paraqitur në uniforma dhe të armatosur në disa vendvotime gjatë zgjedhjeve komunale.

Kosova ka kërkuar që shpërbërja të ndjekë këtë rrjedhë të ngjarjeve: MC duhet të shpallet (ose klasifikohet) si një strukturë ilegale e sigurisë; ajo duhet të shpërbëhet plotësisht, përfshirë mbylljen e të gjitha objekteve, dorëzimin e armëve dhe pajisjeve të tjera. Ajo po ashtu ka deklaruar që anëtarët e saj duhet të integrohen në institucionet e Kosovës dhe për këtë janë diskutuar idetë fillestare.

Më në fund, më 13 dhjetor, në takimin mes kryeministrave dhe PL Ashton, çështja e shpërbërjes së 'mbrojtjes civile' u ngrit prapë dhe fundi i marsit 2014 është caktuar si afat i fundit. Në të njëjtën kohë, integrimi i anëtarëve të MC në kornizën e sigurisë së Kosovës do të ndodhë, për çfarë pala kosovare ka shprehur gatishmërinë e saj.

2.2.3 Çarmatosja e strukturave serbe paralele të sigurisë

Që nga fillimi i bisedimeve për zbatim të marrëveshjeve, Kosova e ka ngritur çështjen e çarmatosjes së të gjitha strukturave serbe paralele të sigurisë. Deri më tash, kjo çështje nuk është adresuar.

2.3. Integrimi i pjesëtarëve serbë në Policinë e Kosovës

Në përputhje me qasjen e njëkohshme, mbyllja e objekteve të MUP-it do të duhej të pasohet nga procesi i integritit të ish anëtarëve të MUP-it në kornizën policore të Kosovës. Integrimi i planifikuar për t'u përmbyllur më 30 shtator, siç ishte arritur marrëveshja në Bruksel, është vonuar për shkak të dështimeve nga pala serbe për të paraqitur listën e pjesëtarëve të interesuar të bëhen pjesë e institucioneve përkatëse të Kosovës.

Më 5-6 qershor 2013, palët u pajtuan që data e fundit për integrimin e plotë të strukturave serbe të sigurisë në Kosovë të jetë 30 shtatori 2013. (Neni 7 i Përfundimeve të takimit më 5-6 qershor 2013).

Në një varg të takimeve pasuese në Bruksel, pala kosovare ka kërkuar listën e pjesëtarëve që janë të gatshëm të integrohen në Policinë e Kosovës.

Më takimin më 30 korrik-1 gusht, pala serbe konfirmoi se ata do të dorëzonin një listë të "zyrtarëve të gatshëm" me të dhënat relevante të nevojshme për integrimin e tyre në strukturën e Policisë së Kosovës jo më vonë se deri më 16 shtator 2013. Megjithatë, ajo ka dështuar në përmbushjen e obligimeve të saj deri në dhjetor kur ky proces më në fund ka filluar.

Ndërkohë dhe në bazë të një parimi të një qasje të njëkohshme, Kosova ka punuar në procesin përgatitor për integrim në aspektin ligjor, profesional dhe praktik.

Kosova ka dorëzuar një Plan Integrimi, në bashkëpunim të ngushtë me EULEX-in. Plani i integritit ka theksuar në hollësi të gjithë hapat që duhet të ndërmerren në procesin e integritit: si procedurat e punësimit, orientimin si dhe trajnimet e specializuara, caktimet në vende të punës, gradimet, etj.

Kosova ka shqyrtuar procedurat dhe harmonizimin e dokumentacionit për integrimin e ish pjesëtarëve të MUP-it në përputhje me ligjet e Kosovës dhe Marrëveshjen e Brukselit (si deklarata, kontrata e pakufizuar e punës, aplikimi, modulet e trajnimit, etj.).

Pas takimit të fundit në Bruksel, të mbajtur më 10-11 dhjetor, dhe pas pranimit, me një vonesë prej gjashtë muajsh, të listës së kandidatëve të mundshëm, të cilët kanë shprehur interesim për integrim në Policinë e Kosovës (duhet të theksohet se lista prej 337 kandidatëve ka tejkaluar shifrën për të cilën është arritur pëlqimi nga palët për integrimin 250/270 policëve. Veç kësaj, pas një verifikimi fillestar të listës së plotë të bërë bashkërisht nga Agjencia për Regjistrin Civil, PK-në dhe EULEX-in, disa dolën se nuk ishin qytetarë të Kosovës, përderisa disa të tjerë duket se janë të përfshirë në aktivitete penale, andaj nuk do të merren në konsideratë për integrim në PK), Kosova menjëherë filloi integrimin. Veprimet e mëposhtme janë ndërmarrë:

Më 12 dhe 13 dhjetor, Kosova ka kryer verifikimin e profileve të 20 kandidatëve. Veç kësaj, EULEX-i ka kryer verifikimin dhe shikimin e së kaluarës së këtyre 20 kandidatëve.

Më 13 dhjetor, 16 kandidatët e parë nënshkruan kontratat (njëri prej tyre nuk i përmbushi kushtet për ta nënshkruar kontratën pasi që ishte zjarrfikës e jo polic dhe 3 të tjerë nuk ishin informuar nga MUP-i serb).

Më 16 dhjetor, filloi trajnimi orientues njëjavor. *(Në këtë datë u nënshkruan dy kontrata nga pjesëtarët të cilët nuk ishin informuar më 13 dhjetor dhe nga njëri që nuk ishte i informuar pasi që ishte në spital në Beograd dhe se na kishte njoftuar se do të ishte pjesë e procesit kur të përmirësohej gjendja e tij. Gjatë trajnimeve, njëri pjesëtar ka munguar dhe ka deklaruar se nuk do të jetë pjesë e procesit.)*

Më 19 dhjetor, pas trajnimit, 16 pjesëtarë u certifikuan dhe u integruan në strukturën e KP-së dhe pastaj janë caktuar në vendet e tyre të punës në stacionet policore në veri.

Një nga parimet për të cilin është arritur pëlqimi brenda grupit për zbatim të sigurisë është çështja e gradimit dhe të dy palët e kanë pranuar propozimin e Kryesueses për ulje gradash. Policia e Kosovës është e gatshme të zbatojë këtë pjesë të marrëveshjes duke dhënë gradat në përputhje me marrëveshjen e arritur në Bruksel, por prapë, pala serbe po dështon në përmbushjen e obligimeve të saj duke mos dorëzuar dosjen e plotë të secilit pjesëtar. Në mungesë të kësaj, pala kosovare nuk është në gjendje të vazhdojë me gradimin e policëve të integruar në PK.

Si vazhdimësi e këtij procesi, më 27 dhjetor 2013, edhe 63 kandidatë të tjerë i nënshkruan kontratat me Policinë e Kosovës. Ata (përfshirë edhe policin nga rrethi i parë i cili ishte në spital në Beograd) do të fillojnë trajnimin orientues më 13 janar 2014. Verifikimi dhe shikimi i së kaluarës së tyre është kryer nga Policia e Kosovës dhe nga EULEX-i. Ndërkohë, Policia e Kosovës është duke kryer verifikimet edhe për 100 kandidatë të tjerë/ish pjesëtarë të MUP-it, të cilët kanë shprehur gatishmëri t'i bashkohen PK-së. Andaj procesi i integrit, respektivisht ato

aspekte të cilat janë obligim i institucioneve të Kosovës, është duke shkuar sipas planifikimit dhe sipas dinamikës së duhur.

Sipas marrëveshjes, Serbia do të paguajë pensionet dhe do të vazhdojë të paguajë sigurime shëndetësore në një mënyrë transparente për policët serbë të integruar në sistemin e Kosovës. Shuma e pensionit nuk duhet të tejkalojë shumën që i paguhet një polici në pension në Serbi. Sigurimi shëndetësor do të paguhet nga Serbia deri kur Kosova të miratojë skemën e sigurimeve shëndetësore.

3. DREJTËSIA

Për çështje të drejtësisë, Marrëveshja e Brukselit (Neni 10) dhe Plani i Zbatimit thërret për shpërbërjen e gjykatave paralele serbe dhe zyrave të prokurorisë dhe integrimin e stafit gjyqësor serb në institucionet gjyqësore të Kosovës.

Në përputhje me planin e detajuar, për të cilin palët kanë arritur marrëveshje (i përfshirë në përfundimet e BE-së të datës 31 maj 2013), afati i fundit për shpërbërjen dhe integrimin në fushën e drejtësisë ishte 1 shtatori 2013.

Deri më sot, ka pasur përparim të kufizuar të zbatimit. Në pjesën më të madhe, zbatimi ka përparuar përkitazi me planet për integrim dhe shpërbërje por jo edhe në praktikë. Zbatimi praktik është bërë në lidhje me ndërprerjen e marrjes së rasteve të reja, pasi që gjykatat paralele serbe në Kosovë nuk po pranojnë më raste të reja penale dhe që nga 1 shtatori ato kanë ndërprerë gjykimin e atyre rasteve. Megjithatë, gjykata paralele dhe zyrat e prokurorisë ende nuk janë mbyllur dhe pagesat e pagave ende nuk janë ndërprerë nga Serbia. Integrimi i stafit gjyqësor serb në institucionet gjyqësore të Kosovës ende nuk ka filluar. Ky proces është ngushtë i lidhur me marrëveshjen e hollësishme për strukturën e gjykatave, objekteve dhe numrit të nevojshëm të stafit gjyqësor që duhet të integrohet. Përparim kyç është arritur në çështjen e strukturës së gjykatave, që thotë se Gjyqësori i Kosovës do të vazhdojë të operojë si një gjyqësor i integruar me një Gjykatë Supreme, një Gjykatë të Apelit, një Gjykatë Themelore dhe një Zyrë të Prokurorisë Themelore për rajonin e Mitrovicës. Logjika etnike e gjykatave të cilën Serbia po e përkrah ka dëmtuar përparimin e mëtejshëm.

3.1. Shpërbërja e gjykatave paralele serbe dhe zyrave të prokurorisë

Plani për të cilin është arritur marrëveshja përshin këto elemente: organet gjyqësore në Kosovë që operojnë jashtë kornizës rregullative të Kosovës do të vendosin për rastet e filluara para 15 korrikut 2013. Vendimet nga një organ gjyqësor do të nxirren deri më 1 shtator 2013, deri më këtë datë, të gjitha objektet e gjykatave serbe në Kosovë do të mbyllën. Që nga 15 korriku i vitit 2013, pas një vendimi të marrë më 17 qershor 2013 nga Serbia, të gjitha paraqitjet për hetime ose raste të reja në këto organe gjyqësore do të ruhen prej tyre për paraqitje dhe trajtim në të

ardhmen brenda kornizës Gjyqësore të Kosovës. Deri më 16 korrik, EULEX-i do të pranojë informatat për të gjitha paraqitjet e regjistruara para asaj date në lidhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale. Deponimi i rasteve do të mundësojë përputhjen me afatet kohore dhe paraqitjen e rasteve në Gjykatë, me ndihmën e EULEX-it. Rastet urgjente penale, të paraqitura pas 15 korrikut 2013, do të trajtohen nga EULEX-i deri më 1 shtator 2013. Rastet urgjente civile (statusi civil, mosmarrëveshjet e punës, përçarjet rreth pronave), të paraqitura pas 15 korrikut 2013, do të trajtohen nga organet gjyqësore deri më 1 shtator 2013. Seancat dëgjimore nga organet gjyqësore pas 15 korrikut 2013 do të lidhen vetëm me rastet urgjente civile të paraqitura pas 15 korrikut 2013 dhe rastet e hapura të caktuara para 15 korrikut 2013. Të gjitha seancat dëgjimore për rastet penale do të kryhen para 15 korrikut 2013.

Pasqyra e zbatimit të tyre është si në vazhdim:

Që nga 15 korriku, gjykatat paralele serbe në Kosovë nuk po pranojnë më raste të reja penale dhe që nga 1 shtatori ato kanë ndërprerë gjykimin e atyre rasteve. EULEX-i ka verifikuar përputhshmërinë me kushtet e marrëveshjes për ndërprerjen e rasteve. Rastet e reja pas 15 korrikut po deponohen dhe do të transferohen tek Gjykatat e Kosovës për trajtim të mëtejshëm.

Megjithatë, gjykatat paralele serbe vazhdojnë të trajtojnë raste civile urgjente, ndonëse është dashur ta ndërpresin këtë sipas planit të marrëveshjes.

Nuk ka shenja të qarta ose të dukshme në terren që tregojnë se strukturat paralele të drejtësisë janë duke u shpërbërë. Ekzistojnë disa shenja se strukturat paralele gjyqësore në Kosovën veriore ende janë duke pranuar raste të reja për çështje urgjente të rasteve civile.

Serbia vazhdon të paguajë pagat për personelin paralel gjyqësor që operon në Kosovë.

3.2. Integrimi i stafit gjyqësor serb në institucionet ligjore të Kosovës

Ende nuk është arritur marrëveshje për integrimin e stafit gjyqësor paralel të interesuar për t'ju bashkuar institucioneve gjyqësore të Kosovës. Kjo marrëveshje është ngushtë e lidhur me marrëveshjen e hollësishme për strukturën e gjykatave, objekteve dhe numrit të kërkuar të stafit gjyqësor, e cila ende pritet të zbatohet.

Në përputhje me qasjen e njëkohshme, ekzistojnë nivele të ndryshme të përparimit në lidhje me aspektet e ndryshme të planit për integrim.

Në një fazë të hershme të zbatimit, pala kosovare ka dorëzuar një plan integrimi në lidhje me modalitetet e rekrutimit dhe kriteret për integrim, për të cilin pastaj u arrit marrëveshja me BE-në (Konkluzionet e BE-së më 5 korrik 2013, nenet 2 dhe 3). Kriteret bazohen në Ligjin e Kosovës për Gjykatat (neni 26) dhe Ligjin e Kosovës për Prokurorin e Shtetit (neni 19), që paraqet një listë të hollësishme të kriterëve për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët. Procesi i integrimin, i

lehtësuar nga EULEX-i, do të konsiderohet t'i ketë përmbushur këto kritere. EULEX-i do të orientojë kandidatët për postet në dispozicion në strukturat ligjore dhe ligjet e Kosovës, siç të shihet e përshtatshme nga EULEX-i dhe dy anëtarë të secilit këshill të Kosovës do të jenë drejtpërsëdrejti të emëruar për orientim për gjyqtarët dhe prokurorët.

Lista e personelit gjyqësor serb të interesuar për t'ju bashkuar institucioneve të Kosovës është ende në pritje. Serbia ende nuk e ka dorëzuar një listë të tillë, ndonëse ishte e obliguar ta bënte këtë menjëherë pas dekretimit të Ligjit për Amnistinë në Kosovë, më 17 shtator 2013. (Në përputhje me Konkluzionet e BE-së të datës 31 maj 2013, neni 6).

Në lidhje me çështjen e pensioneve dhe sigurimeve pensionale për personelin gjyqësor serb të integruar në institucionet e Kosovës, është arritur një marrëveshje mes palëve. Delegacioni i Kosovës është pajtuar që Serbia të vazhdojë kontributet për pension dhe sigurim shëndetësor për stafin gjyqësor të cilët do të integrohen në institucionet gjyqësore, me kusht që Serbia, në ditën e emërimit të tyre në institucionet e Kosovës, të shkarkojë ata gjyqtarë dhe prokurorë dhe të ndalë pagesën e pagave të tyre. Veç kësaj, kjo ndërlidhet po ashtu me obligimin që Serbia të vazhdojë të paguajë kontributet pensionale dhe shëndetësore për personelin e integruar pa ndërprerje deri në pensionimin e tyre, në nivel të njëjtë, sikur të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Serbi, me përjashtim të rasteve kur Këshilli Gjyqësor i Kosovës ose Këshilli Prokurorial i Kosovës i shkëput kontratat e tyre. Në bazë të kushteve të lartpërmendura, Serbia do të dorëzonte raporte tremujore të KGJK dhe KPK në lidhje me këto përfitime pensionale dhe shëndetësore.

3.3. Struktura

Për çështjen e strukturës, është arritur marrëveshja në nivel të kryeministrave dhe PL Ashton më 13 dhjetor 2013, që thotë se Gjyqësori i Kosovës do të vazhdojë të veprojë se një gjyqësor i integruar me një Gjykatë Supreme, një Gjykatë të Apelit, një Gjykatë Themelore dhe një Zyrë të Prokurorisë Themelore për rajonin e Mitrovicës.

Megjithatë, nuk ka marrëveshje të detajuar në lidhje me strukturën, objektet dhe numrin e stafit që duhet integruar, gjë që ne e konsiderojmë si pjesën më të rëndësishme dhe më të vështirë të marrëveshjes. Qëndrimi i palës serbe, i paraqitur në takimin e KM-ve, ndjek linjën e gjykatave etnike, të kufizuara brenda katër komunave veriore, me elemente të ndarjes, pasi që ato do të merreshin vetëm me raste serbe dhe se objektet do të ishin të ndara për Mitrovicën e jugut dhe të veriut. Pala kosovare i ka kundërshtuar ashpër këto propozime, pasi që ato nuk përputhen me ligjet e Kosovës dhe Marrëveshjet e Brukselit dhe me parimet universale të drejtësisë të cilat janë pa ndarje sipas vijave etnike; andaj, takimi ka përfunduar pa marrëveshje në këtë çështje. Më shumë punë duhet të bëhet në këtë çështje si dhe për numrin e saktë të stafit gjyqësor dhe përbërjen etnike të atyre strukturave.

4. LIGJI PËR AMNISTINË

Kosova ka miratuar Ligjin për Amnistinë më 17 shtator 2013 dhe që nga atëherë ai është zbatuar në mënyrë konsekuente. Me miratimin e këtij ligji, Qeveria e Kosovës konfirmon vullnetin e saj politik për integrimin e qytetarëve serbë të veriut në institucionet e Kosovës. Ligji për amnistinë paraqet një instrument kyç të masave për ngritje të besimit dhe kthimin e besimit mes institucioneve të Kosovës dhe serbëve në pjesën veriore të shtetit tonë, që është shkatërruar nga ndërhyrjet negative të Serbisë që nga përfundimi i luftës në vitin 1999. Në fakt, Qeveria e Kosovës ka qenë e suksesshme në integrimin e të gjitha komuniteteve, përfshirë shumicën e serbëve, dhe është duke punuar shumë për të integruar serbët e veriut, për çfarë Marrëveshja e Brukselit dhe lehtësimi i BE-së janë të rëndësishme parësore. BE-ja po ashtu konfirmon se Ligji për Amnistinë është instrumenti kryesor që trason rrugën për integrimin e serbëve të pjesës veriore në institucionet e Kosovës. Kronologjia e miratimit të këtij ligji, e paraqitur më poshtë, tregon përpjekjet maksimale nga institucionet e Kosovës dhe spektri politik për ta miratuar ligjin në kohën e duhur.

- Më 25 qershor 2013, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Projektligjin për Amnistinë dhe menjëherë e procedoi atë për miratim nga Kuvendi i Kosovës.
- Më 11 korrik 2013, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin për Amnistinë Nr. 04/L-209, (me 90 vota pro, 17 vota kundër dhe një abstenim)
- Më 19 korrik 2013, Ligji për Amnistinë ishte subjekt vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese në bazë të një urdhri për shqyrtim të natyrës së tij kushtetuese (të sponsorizuar nga një grup i parlamentarëve të cilët e kundërshtuan përmbajtjen e tij dhe procedurën e miratimit)
- Më 3 shtator 2013, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës vendosi pozitivisht për kushtetutshmërinë e Ligjit për Amnistinë
- Më 17 shtator 2013, Ligji për Amnistinë u ratifikua me dekretin Nr. DL-051-2013, nga Presidenti i Republikës së Kosovës
- Më 21 shtator 2013, Këshilli Prokurorial i Kosovës nxori Urdhëresën me nr. 01/2013 për Zbatimin e Ligjit për Amnistinë.

5. MBLEDHJA E TË HYRAVE DOGANORE

Ka pasur përparim shumë të mirë në zbatimin e Marrëveshjes për mbledhjen e të hyrave doganore në pikat kufitare në pjesën veriore të Kosovës dhe Serbisë, respektivisht në Jarinjë dhe në Bërnjak, të arritur më 17 janar 2013. Marrëveshja është në frymën e njëjtë me marrëveshjet e mëherëshme përkatëse, në veçanti, me IBM, marrëveshjen CEFTA, Traktatin e Lisbonës dhe legjislacionin përkatës të BE-së.

- Mbledhja e taksave të aplikueshme doganore dhe të akcizës si dhe të TVSH-së (taksës mbi vlerën e shtuar) në PKK-të filloi më 14 dhjetor 2013, duke normalizuar gjendjen në këtë zonë për shumë vite. Bordi menaxhues i Fondit Zhvillimor u mbledh para fillimit të mbledhjes së taksave, më 13 dhjetor 2013 në përputhje me Nenin 12 të Marrëveshjes.
- Mbledhja e të gjitha të hyrave paguhet ose me para të gatshme ose përmes pikave të Bankës Raiffeisen në Kosovë.
- Regjistrimi i kompanive dhe referenca për Fondin Zhvillimor në fatura dhe pasqyra bankare po bëhet në përputhje me dispozitat e marrëveshjes (neni 4)
- Për mallrat që i nënshtrohen regjimit të kontrollit (licencimit), do të kenë një periudhë kalimtare prej tre muajsh. Gjatë kësaj periudhe, kompanitë importuese duhet të aplikojnë për licencë në përputhje me legjislacionin e Kosovës. Gjatë procesit të licencimit dhe jo më vonë se 31 dhjetori 2014, këto kompani mund të sjellin në Kosovë këto mallra dhe të paguajnë të taksat, përveçse nëse mangësitë përbëjnë një rrezik serioz për shëndetin ose ambientin. Mallrat për të cilat ekziston e drejta ekskluzive për shpërndarje, nuk do të ndalohen të hyjnë, me kusht që ato mallra të jenë produkte origjinale.
- Para fillimit të zbatimit të marrëveshjes, Doganat e Kosovës, në bashkëpunim me EULEX-in kanë filluar një fushatë shtatë ditore informuese për të rritur vetëdijen publike për këtë çështje.
- Doganat e Kosovës kanë paraqitur një Plan Operacional detal në përputhje me legjislacionin e Kosovës dhe marrëveshjen doganore për mbledhje të taksave.

Deri më tash, zbatimi i marrëveshjes po shkon mirë dhe EULEX-i është i pranishëm në përputhje me mandatin e vet, dhe për aq sa zgjat mandati i tij, dhe në përputhje me marrëveshjen IBM.

6. FONDI ZHVILLIMOR

Pas arritjes së marrëveshjes për doganat në dy pikëkalimet kufitare mes Kosovës dhe Serbisë, në Jarinjë dhe Bërnjak, të arritur më 17 janar 2013, Kosova ka vazhduar angazhimin për themelimin e një Fondi Zhvillimor për pjesën veriore në përputhje me nenet 7,8,9 dhe 11, me qëllim të hapjes së rrugës për mbledhjen e menjëhershme të detyrimeve doganore në këto dy pikëkalime kufitare.

Neni 11, ftonte për themelimin e Fondit brenda 7 ditësh nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje. Pas shqyrtimit të të gjitha shtigjeve plotësim ndryshimeve të menjëhershme të bëra në Ligjin për Buxhetin e Kosovës, alternativa e vetme e mundshme mbeti miratimi i rishikimit të buxhetit nga Kuvendi i Kosovës për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2013. Kosova i njoftoi lehtësuesit e BE-së për vonesat objektive dhe kërkoi për punë të njëkohshme për hapat e tjerë përgatitorë për zbatimin e Marrëveshjes.

Më 25 korrik 2013, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin (nr. 04-L-165) i Republikës së Kosovës për vitin 2013 u miratua nga Kuvendi. Më 12 shtator 2013, ai u ratifikua me dekret të Presidentes së Republikës së Kosovës (nr. DL-49-2013). Ndërkohë, më 2 shtator 2013, Gjykata Kushtetuese e Kosovës vlerësoi pozitivisht kushtetutshmërinë e ligjit, të nisur nga një grup i parlamentarëve.

Megjithatë, nuk ishte bërë asnjë punë përgatitore në ndërkohë, qartazi pasi që agenda e BE-së dominohej nga çështje të tjera më urgjente që lidhen me Marrëveshjen e Brukselit.

Puna tjetër rifilloi në Bruksel diku në Shtator për t'u përfunduar më 13 dhjetor kur u themelua Bordi i Fondit Zhvillimor dhe një ditë më pas filloj mbledhja e detyrimeve doganore në dy pikëkalimet kufitare të IBM-it në Jarinjë dhe në Bërnjak. Në aspektin kohor, të dy veprimet do të mund të kryheshin më herët, por në aspektin politik, BE-ja konsideronte se pas mbajtjes së zgjedhjeve komunale do të ishte moment më i mirë.

Fondi zhvillimor është themeluar për të promovuar zhvillimin socio-ekonomik dhe për të përfituar popullata vendore e pjesës veriore të Kosovës. Të hyrat e mbledhura në pikëkalimet e përbashkëta kufitare dhe zonat e përbashkëta të IBM-it në Jarinjë/Rudnicë dhe në Bërnjak/Tabavije (detyrimet e aplikueshme dhe taksat e akcizës, përfshirë TVSH-në) nga kompanitë që operojnë dhe mallrat që destinohen për popullatën lokale të komunave të pjesës veriore do të barten në Fondin Zhvillimor në përputhje me Marrëveshjen dhe legjislacionin e Kosovës. Paratë në Fondin zhvillimor janë para publike dhe do të trajtohen si të tilla gjatë menaxhimit dhe shpenzimit të tyre. Fondi zhvillimor mund të rritet duke shtuar kontribute të tjera nga donatorët, në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

7. ASOCIACIONI

Themelimi i Asociacionit të komunave me shumicë serbe pritet të bëhet pas inaugurimit të strukturave të porsazgjedhura komunale.

Një ekip menaxhues nga përfaqësuesit e katër komunave veriore, me mbështetje nga Ministria e Kosovës për Administrimin e Pushtetit Lokal (MAPL) është themeluar më 14 qershor 2013, në përputhje me Planin e Zbatimit. Roli i këtij ekipi është të përgatitë projektin e statutit dhe të ofrojë mbështetje tjetër teknike/logjistike për Asociacionin (siç parashihet me Termat e Referencës ToR për të cilat është arritur pajtimi në Bruksel). Anëtarët e ekipit menaxhues në fillim kanë refuzuar të bashkëpunojnë me zyrtarët e MAPL-së dhe falë ndihmës së EUSR, u mbajt një takim i përbashkët në pjesën veriore të Mitrovicës më 21 tetor 2013, me qëllim të përgatitjeve që ata duhet të bëjnë në lidhje me mbështetjen logjistike dhe hartimin e statutit të Asociacionit.

Në takimin e përbashkët të mbajtur në Bruksel më 3 dhjetor 2013, ekipi menaxhues njoftoi se ata ende nuk kishin filluar me hartimin e statutit, përderisa delegacioni i MAPL-së prezantoi një projekt statut i cili është i dizajnuar në bazë të ligjeve të Kosovës dhe Marrëveshjes së Brukselit.

8. ZYRAT NDËRLIDHËSE

Marrëveshja për zyrat ndërlidhëse mes Kosovës dhe Serbisë është arritur më 31 maj 2013 në Bruksel. Misioni i zyrtarëve ndërlidhës është të përcjellin të gjitha çështjet që lidhen me normalizimin e marrëdhënieve dhe të adresojnë problemet e përditshme që mund të ndodhin. Zyrat e tyre janë siguruar nga delegacionet e BE-së në të dy vendet. Bashkimi Evropian ofron lehtësim për të arritur këto aranzhime dhe për të ndihmuar në zbatimin e tyre në përputhje me praktikën më të mirë të BE-së.

Në përputhje me marrëveshjen, Këmbimi i Zyrtarëve Ndërlidhës duhej të fillonte më 15 korrik 2013. Si Serbia ashtu edhe Kosova i filluan misionet e tyre diplomatike më 17 korrik 2013. Këmbimi efektiv i zyrtarëve ndërlidhës shënoi një fillim shumë të mirë. Megjithatë, zbatimi i kushteve të tjera të marrëveshjes është i pjesshëm. Deri më sot, gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes, zyra ndërlidhëse e Kosovës në Beograd nuk ka qenë në gjendje të kompletojë të gjitha aranzhimet logjistike dhe operative. Për më tepër, misioni kryesor i vazhdimit të normalizimit të marrëdhënieve përmes kontakteve të drejtpërdrejta me autoritetet e shteteve përkatëse nuk është konsoliduar ende. Është bërë përparim në përfundimin e çështjeve të statusit ligjor/regjistrimin e ID-ve, përfshirë shërbimet e kënaqshme të mbrojtjes së afërt për zyrtarët ndërlidhës të Kosovës dhe stafit të tij të ofruar nga autoritetet e Serbisë; megjithatë, zyrtari ndërlidhës serb në Kosovë ende nuk ka ndërmarrë hapa në këtë drejtim. Çështjet e hapura përfshijnë: vulën e Zyrës Ndërlidhëse të Kosovës, llogarinë bankare dhe sigurimin shëndetësor të zyrtarit dhe stafit.

Gjendja e hollësishme e procesit të zbatimit është si në vazhdim:

Kosova e filloi zyrtarisht këtë operacion më 25 korrik 2013 (hapja e Zyrës u bë në mënyrë simbolike më 17 qershor 2013).

Statusi ligjor dhe regjistrimi: më 5 gusht Kosova filloi zyrtarisht procedurat për rregullimin e statusit ligjor, përderisa më 12 gusht, autoritetet përkatëse të Serbisë u përgjigjën. Më 15 gusht 2013, Departamenti për Çështje Ligjore i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës u përgjigj pozitivisht në lidhje me procedurat e regjistrimit për vazhdimin e vlerësimit duke deklaruar se “dokumenti është brenda kornizës së Marrëveshjes.” Menjëherë, ne vazhduam me hapat e nevojshëm të radhës për regjistrim në Administratën Tatimore serbe. Pas më shumë se një muaji, pas aplikacionit dhe pas trysnisë nga Delegacioni i BE-së në Serbi, më 19 shtator 2013, Administrata Tatimore e lëshoi një “Certifikatë regjistrimi.” Kjo certifikatë ishte parakusht për çdo aktivitet në Republikën e Serbisë. Për ilustrim, para se ta siguronim këtë certifikatë, asnjë operator mobil nuk mund të na jepte një SIM kartelë për telefona mobilë, me gjithë garancitë nga disa ambasada në Beograd. Po ashtu, ishte e pamundshme madje edhe të bëheshin pagesa përmes sistemit bankar.

Kartelat identifikuese ID: kjo është zgjidhur me vonesa që kërkuam një takim shtesë në Bruksel. Në atë takim, të mbajtur më 1 tetor 2013 në Bruksel, Qeveria e Serbisë, përmes zyrtarit të saj ndërlidhës në Republikën e Kosovës filloi përgatitjen e këtyre kartave deri në mes të tetorit. Edhe në këtë rast, kishte vonesa dhe ID-të u bënë gati vetëm më 21 nëntor 2013 kur ne i pranuan ato (duhet të theksohet se data e nxjerrjes së l shkruan të jetë 17 tetori 2013).

Vulat: Për t’u bërë Zyra ndërlidhëse e Republikës së Kosovës në Serbi plotësisht operacionale, duhet zgjidhur edhe çështja e vulave. Në përputhje me nenin 17 e kësaj Marrëveshjeje që thotë “afatet do të zbatohen përmes legjislacionit të palës përkatëse,” ne kërkuam që vula të përmbajë stemën e Kosovës (formatin e njëjtë si edhe vulat e tjera të misionëve diplomatike të Republikës së Kosovës). Pala serbe pretendonte se vula duhej të ishte “neutrale ndaj statusit” pa stemë. Çështja mbetet të zgjidhet në fazën e ardhshme, për çfarë pala kosovare ka kërkuar takim në Bruksel gjatë janarit të vitit 2014.

Kontaktet me autoritetet serbe – në lidhje me kontaktet me autoritetet e vendit pritës, ideja fillestare ishte që personat kontaktues për zyrtarët ndërlidhës të ishin Shefat e Personelit të Kryeministrave, në takimin e mbajtur më 7 nëntor 2013 (përmes video konferencës), ne u pajtuam që kërkesat të adresohen pa “ndërmjetësim” te autoritetet pritëse me shprehje të interesimit për takim. Në fazën fillestare, kërkesat për takim do të bëhen të njohura për përfaqësuesit përkatës të BE-së, thjesht për të siguruar që ai të gjejë një derë të hapur.

Llogaritë bankare: përkitazi me llogaritë bankare, ne kemi filluar komunikimin me bankat komerciale dhe jemi në pritje të përgjigjes përfundimtare.

Sigurimi shëndetësor: ne kemi filluar me procedurat dhe kontaktet e para janë bërë më 5 dhjetor 2013 (kompania e sigurimeve GENERALI, UNIQA Company) dhe deri më tash nuk po shohim vështirësi për kontraktim.

Mbrojtja e afërt: që nga dita e parë e punës ne kemi pasur mbrojtje të afërt nga policia e Serbisë siç është paraparë nga Marrëveshja. Ne kemi ekipet statike dhe mobile në dispozicion. Ekipet statike janë vendosur në hotel dhe pas akomodimit tonë në banesa, ne kemi një kabinë policore jashtë dhe 24 orë mbrojtje. Ekipet mobile përcjellin çdo lëvizje jashtë zyrave ose banesave. Që nga 21 nëntori 2013 janë shtuar masat e sigurisë.

Udhëtime të kufizuara: ndonëse na është premtuar se nga gjysma e muajit tetor 2013 stafi i Misionit të posaçëm në Republikën e Serbisë nuk do të ketë kurrfarë kufizimesh në udhëtim, ende nuk ka ndonjë njoftim se diçka ka ndryshuar në këtë drejtim. Duhet përmendur se, ashtu si është raportuar, tri (3) herë ka pasur vonesa gjatë kalimit të kufirit me veturë, ndërsa për takimin e datës 1 tetor 2013 në Bruksel Zyrtarit Ndërlidhës të Kosovës i është pamundësuar fluturimi nga aeroporti i Beogradit drejt Brukselit ndonëse njoftimi është bërë me kohë dhe bileta e udhëtimit ishte blerë. Autoritetet e Serbisë patën premtuar asokohe se edhe kjo gjë do të ndryshojë pas pajisjes me ID kartela – ende nuk kemi pranuar ndonjë njoftim sa i përket ndryshimit të regjimit dhe nëse tani mund të kalojmë kufirin në të gjitha pikëkalimet kufitare pa kufizime.

9. MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT (IBM)

Përshkrimi i çështjes

Marrëveshja për IBM në të gjitha gjashtë pikëkalimet kufitare mes Kosovës dhe Serbisë është arritur më 2 dhjetor 2011 dhe Protokollin Teknik është parafuar (janë vendosur inicialet) nga të dy palët më 26 shkurt 2012. Qeveria e Kosovës e nënshkroi dhe miratoi Protokollin Teknik në mënyrën e duhur dhe e dërgoi atë në BE më 29 shkurt 2012. Zbatimi i tij ngeci për shtatë muaj për shkak të mungesës së gatishmërisë së qeverisë së Serbisë për ta nënshkruar atë, gjë që më në fund e bëri në fund të shtatorit të vitit 2012. Procesi u pasua nga marrëveshja për Planin e Veprimit nga Grupi Punues për Zbatimin e IBM-së. Protokollin Teknik dhe Plani i Veprimit i përcaktuan dy faza të pikëkalimeve të IBM-it, një fazë kalimtare me ndërtesa të përkohshme dhe një fazë të dytë me ndërtimin të ndërtesave të përhershme, në përputhje me standardet e BE-së. Në këtë aspekt, palët u pajtuan të themelojnë gjashtë Pikëkalime Kufitare (PKK) adekuate, tri prej tyre me lokacion në territorin e Kosovës dhe tri në territorin e Serbisë. Pala pritëse është përgjegjëse për mbrojtjen dhe sigurinë e autoriteteve të palës tjetër të dërguar në PKK të IBM, në territoret e tyre përkatëse dhe po ashtu për sigurinë e zyrtarëve nga pala tjetër si dhe për sigurimin e gjithë infrastrukturës dhe logjistikës së nevojshme. Kosova i ka finalizuar tri PKK të IBM në territorin e vet në kohën e duhur, siç parashihej nga Plani i Veprimit. Serbia i ka vonuar tri të tjerat. Si pasojë, në vend që të fillohej puna e tyre më 31 tetor 2012, katër PKK-të e përbashkëta të IBM duhej të prisnin deri në dhjetor të atij viti – PKK-të e përbashkëta në Jarinjë dhe Merdare e kanë filluar punën më 10 dhjetor 2012 ndërsa PKK-të Dheu i Bardhë dhe Bërnjak më 31 dhjetor 2012. PKK-të e fundit të IBM-ve u funksionalizuan më 31 mars 2013 (PKK Mutivodë dhe PKK Muçibabë).

Ia vlen të përmendet se procesi i zbatimit nuk ishte i qetë. Ai u përball me incidente të ndryshme si kundër reagim, përfshirë djegien/dëmtimin e objekteve në Jarinjë dhe Bërnjak dhe ku kishte të shtëna zjarri kundër personelit lokal dhe të KFOR-it në këto dy PKK-të e lartcekura (më 27 korrik 2011) dhe gjashtë muaj më vonë kishte sulme dhe lëndime të trupave gjermane në Zveçan gjatë misionit të tyre për të hequr një barrikadë (më 1 qershor 2012).

9.1. Pa përparim në zbatimin e fazës së dytë gjatë vitit 2013

Zbatimi i fazës së dytë – ndërtimi i godinave të përhershme për gjashtë PKK-të e IBM nuk ka shënuar ndonjë përparim të dukshëm gjatë vitit 2013. Pala serbe u mundua të anulojë planin për ndërtesa të përhershme, me gjithë nënshkrimin e Protokollit Teknik të IBM. Ata paten pretendime të ndryshme të pabazuara për të ndalur përparimin, si: investimet e bëra për ndërtesat e përkohshme, ndonëse ndërtesat e përhershme do të financohen nga BE-ja; refuzimin e propozimeve të projektit të BE-së për PK të përhershme të IBM, duke u munduar të caktojnë

lokacione të papranueshme, etj. Pala kosovare ka qenë e përkushtuar për zbatimin dhe i ka kontribuar përparimit, përfshirë pranimin zyrtar të propozimit të projektit të BE-së për lokacionin dhe dizajnin e ndërtesave, më 2 shtator 2013. Bisedimet vazhduan në këtë çështje pa ndonjë sukses dhe në fund, BE erdhi me një propozim të ri më 21 nëntor 2013, por prapë ai u refuzua nga Serbia. Lehtësuesi i BE-së vendosi ta vejë këtë çështje në tryezën e diskutimeve të kryeministrave me znj. Ashton, ku më në fund u arrit marrëveshja më 5 dhjetor 2013. Kontraktuesi i rekrutuar nga Komisioni Evropian do të vazhdojë me planet për ndërtesat e përhershme dhe infrastrukturën e nevojshme.

Përparimi i vetëm praktik në këtë çështje ishte shënjimi i pikave të IBM-it në bazë të koordinatave, për të cilat është arritur dakordimi dhe është nënshkruar më 12 dhjetor 2012, në gjashtë pikëkalimet kufitare mes Kosovës dhe Serbisë, të cilat shërbejnë si pika referuese për ndërtesat e përhershme. Ai u bë nga Grupi Zbatues i IBM-së (Kosovë, BE dhe Serbi) gjatë disa ditëve të vizitave të pikëkalimit kufitare dhe u përfundua më 28 mars 2013.

9.2. Zbatimi i aspekteve të tjera të IBM me nivele të ndryshme të përparimit

Në aspekte të tjera të zbatimit të IBM ka nivele të ndryshme të përparimit, si më poshtë:

Mekanizmat për këmbim të informatave

Pala e Kosovës ka qenë shumë aktive dhe serioze në themelimin e mekanizmave me qëllim të këmbimit të informatave me Serbinë në lidhje me funksionimin sa më të mirë të IBM-it. Ky mekanizëm përfshin këmbimin e statistikave për lëvizjen e njerëzve dhe mallrave. Ne kemi ndërmarrë të gjitha masat për themeluar këmbimin e informatave përmes përdorimit të nismës rajonale të themeluar nga BE i quajtur SEED (Këmbimi Sistematik dhe Elektronik i të Dhënave). Në anën tjetër, pala serbe ka vonuar zbatimin e SEED mes Kosovës dhe Serbisë për më shumë se një vit. Që nga 25 nëntori 2013, kur ky mekanizëm u themelua, Kosova ka implementuar informacione prej rreth 10,161 T1 (dokumente transit). Deri më sot, sistemi SEED tregon se 60% e këtyre T1 janë barazuar dhe 40% do të kryhen në të ardhmen kur të dhënat do të krahasohen në mënyrë manuale me kopjet e shtypura nga pikëkalimet kufitare.

Takimet lokale dhe rajonale

Të dy palët janë pajtuar për takime lokale dhe rajonale. Kosova e ka kryer pjesën e vet për të ndihmuar procesin duke themeluar Grupet Punuese Teknike; dhe ngjashëm duke organizuar takimet lokale dhe rajonale. Kosova ka emëruar me kohë personat përgjegjës në agjenci të ndryshme kufitare për të marrë pjesë në këto takime lokale dhe po ashtu ka qenë nikoqir i takimeve të para lokale dhe rajonale. Në fillim, pala serbe ka provokuar palën kosovare duke dërguar ftesat me gjuhë politikisht provokatore, gjë që u tejkalua me intervenimin e BE-së si ndërmjetësues në këtë proces. Kjo gjuhë provokuese ende me raste zë vend në letrat zyrtare serbe kjo ndodh në rastet kur Doganat e Kosovës kërkojnë për ndonjë lloj të dhënash nga Doganat e Serbisë, përgjigja e kthyer nga policia serbe (MUP) është shumë provokuese. Serbia

ka provokuar Kosovën edhe duke vënë simbolet e saj shtetërore në PKK Jarinjë, përkundër kërkesave që zona e IBM duhet të jetë pa simbole, sipas marrëveshjes. Kosova vazhdimisht ka kërkuar për heqjen e tyre dhe, në mungesë të rezultateve në këtë drejtim, e ka bërë të ditur qëndrimin e saj që t'i ekspozojë simbolet e saj shtetërore si reciprocitet. Pas kësaj, Serbia menjëherë i hoqi ato simbole.

Oraret e ndërrimeve & bashkëpunimi

Kosova po ashtu ka përmbushur obligimin e saj për të harmonizuar oraret e ndërrimeve për Doganat dhe Policinë dhe shërbimet e veterinarisë, fitosanitarisë dhe atyre ndihmëse në pikëkalimet kufitare. Kosova e ka njoftuar Serbinë përmes procedurave përkatëse për procedimin e personave, veturave dhe mallrave. Grupi për Zbatimin e IBM-së prezantoi procedurat dhe proceset plotësuese për kontrollin dhe zhdoganimin e personave, veturave dhe mallrave, në përputhje me parimet e IBM-së me qëllim të lehtësimit të trafikut dhe tregtisë legale.

Ne jemi pajtuar po ashtu për procedurat për kontrollime të lehtësuara të trafikut në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme dhe të paparashikuara, të shkaktuara nga nivelet e pazakonshme dhe të rritura të rrjedhës së trafikut. Palët po ashtu kanë miratuar plane për t'u kujdesur për ndonjë ngjarje të paparashikuar dhe/ose të papritur.

IBM & çështja e lirisë së lëvizjes

Kosova ka respektuar plotësisht zbatimin e Lirisë së lëvizjes krahas IBM-it. Por, Serbia shpesh ka vënë pengesa, si në rastin kur ne miratuar dokumente të avancuara në përputhje me BE-në për të jetësuar masat që sigurojnë integritetin dhe sigurinë e dokumenteve, e sidomos të certifikatave të gjendjes civile dhe letërnjoftimeve biometrike. Në shtator, pala serbe mori vendim për të mos lejuar hyrjen në Serbi për qytetarët e Kosovës që kanë ekstrakte të lindjes (në vend të certifikatave të lindjes) dhe së fundi janë duke ua mohuar hyrjen qytetarëve të Kosovës me letërnjoftime biometrike. Me këtë vendim, Serbia ka shkelur pikën 2 të marrëveshjes për Liri të Lëvizjes, e cila u referohet letërnjoftimeve, pa e specifikuar llojin e letërnjoftimeve.

IBM & çështjet doganore

Në fushën e doganave një problem tjetër është se Serbia po vazhdon të shkelë marrëveshjen duke mbledhur taksa doganore nga qytetarët evropianë dhe kosovarë për mallrat që ata i sjellin me vete si gjësende personale dhe mallra jokomerciale. Ky veprim nuk është në përputhje me Marrëveshjen për tregti të lirë (marrëveshja për vulat doganore).

IBM & Veterinaria - fitosanitaria

Në lidhje me certifikatat e fitosanitarisë, Serbia ka refuzuar të pranojë certifikatat e lëshuara nga Agjencia Kosovare për Ushqim dhe Veterinari deri më 23 shtator 2013, kur ne arritëm një marrëveshje në Grupin Zbatues për IBM, kur pas disa ndryshimesh, Serbia pranoi të njohë

certifikatat fitosanitare të Kosovës, ndonëse ende nuk kemi një marrëveshje për njohjen e ndërsjellë të certifikatave të veterinarisë.

IBM & Ndihma e Ndërsjellë Juridike (MLA)

Protokolli Teknik për IBM, neni 39 thekson se me lehtësim të BE-së, palët do të synojnë themelimin e ndihmës së ndërsjellë juridike. Në Grupin Zbatues të IBM-it, ne jemi pajtuar për tekstin për Procedurat për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike mes Kosovës dhe Serbisë, përmes ndërmjetësim të EULEX-it.

Afati i fundit për të nënshkruar veç e veç me BE-në Marrëveshjen për Procedura të Ndihmës së Ndërsjellë Juridike ishte 9 janari 2013 dhe Kosova veprroi dhe e nënshkroi në datën e paraparë, përderisa, në anën tjetër, Serbia e vonoi nënshkrimin e marrëveshjes deri në mes të marsit 2013, kur Kryesuesi i Grupit të Zbatimit të IBM -it e konfirmoi nënshkrimin e Serbisë më 18 mars 2013.

Kosova ka dërguar përmes EULEX-it 1,231 kërkesa (95% prej tyre civile) mes 20 marsit të vitit 2013 dhe 5 dhjetorit të vitit 2013. Por Serbia nuk është përgjigjur në asnjërën prej tyre.

Në përputhje me marrëveshjen përmes EULEX-it, Serbia ka dërguar në Kosovë vetëm një kërkesë në të cilën Kosova është përgjigjur. Ne po ashtu kemi pranuar shumë kërkesa nga Serbia, përmes UNMIK-ut dhe Kosova është përgjigjur në 36 nga 59 prej tyre, ndonëse kjo është në kundërshtim me marrëveshjen.

Është bërë gati një vit qyshkur Kosova ka nënshkruar këtë Marrëveshje dhe gjatë kësaj periudhe, Serbia ia ka konfirmuar shumë herë BE-së se ata do ta zbatojnë atë, por megjithatë, ata vazhdojnë ta zvarrisin, me gjithë faktin se kjo Marrëveshje është nënshkruar nga vetë Kryeministri i Serbisë Ivica Dačić.

IBM & Bashkëpunimi rajonal

Sipas Protokollit Teknik të IBM, Kosova duhet të behët anëtare e organizatave rajonale që merren me migrim, menaxhim të kufijve dhe zbatim të ligjit, në përgjithësi kryesisht në MARRI dhe në SELEC, për shkak të rëndësisë së bashkëpunimit rajonal për të adresuar çështjet e karakterit rajonal. Deri më sot, nuk është bërë përparim për anëtarësimin e Kosovës në këto organizata për shkak të pengesave të shkaktuara nga Serbia.

10. LIRIA E LËVIZJES

Marrëveshja për liri të lëvizjes është zbatuar mjaft mirë që nga 26 shtatori 2011, me përjashtim të pjesës veriore që vazhdon të ketë pengesa të natyrës politike. Ndërkohë, transporti tokësor për pjesëtarët e policisë dhe doganave të Kosovës që operojnë në portat kufitare në Bërnjak dhe në Jarinjë është normalizuar gradualisht, respektivisht në qershor dhe në dhjetor të vitit 2013.

Pas marrëveshjes për mbledhje të të hyrave doganore (17 janar 2013), transporti tokësor duhej të normalizohej menjëherë për zyrtarët e Policisë dhe Doganave të Kosovës dhe zyrtarët e EULEX-it që shërbejnë në pikëkalimet kufitare në Jarinjë (Porta 31) dhe Bërnjak (Porta 1). Megjithatë, lëvizja e tyre e lirë rregullisht është penguar nga barrikatadat, ose më mirë nga logjika e barrikadave në veri. Transportimi ajror i zyrtarëve të Kosovës, me helikopterë të siguruar nga EULEX-i, për muaj të tërë, është parë si alternativë. Më 20 qershor, liria e lëvizjes dhe qasja në Bërnjak përmes rrugëve për zyrtarët e Kosovës dhe EULEX-it filloi dhe ka vazhduar rregullisht që atëherë, me probleme të kohëpaskohshme, përfshirë vdekjen tragjike të pjesëtarit të stafit të EULEX-it nga Lituania (më 19 shtator 2013). Qasja përmes rrugëve në Jarinjë filloi më 7 dhjetor.

Çështja e sigurimeve të veturave është në pritje të një zgjidhjeje afatgjate, qytetarët ende ngarkohen me tarifa të larta.

11. TREGTIA E LIRË

Marrëveshja për tregti të lirë, po ashtu e njohur si marrëveshja për vula doganore, është arritur më 2 shtator 2011 dhe zbatimi i saj nga pala kosovare filloi më 16 shtator 2011, përderisa pala serbe filloi zbatimin e saj kah fundi i shtatorit të atij viti. Ajo bazohet në parimet e CEFTA-s dhe palët u pajtuan të bëjnë çdo përpjekje për të siguruar qarkullimin e lirë të mallrave në përputhje me marrëveshjen. Me këtë marrëveshje, embargoja prej tri vitesh nga Serbia e mallrave të Kosovës është hequr. Që nga fillimi, marrëveshja është zbatuar plotësisht vetëm në katër pikëkalime kufitare mes dy shteteve, sepse ekzistenca e barrikadave rrugore e ka parandaluar për një kohë qarkullimin e mallrave në dy nga pikëkalimet e tjera kufitare në kufirin verior mes Kosovës dhe Serbisë (portat 1 dhe 31). Tregtia e lirë është normalizuar gradualisht në këto dy pikëkalime kufitare falë marrëveshjes IBM-it dhe Marrëveshjes për mbledhjen e të hyrave doganore që ka filluar të zbatohet më 14 dhjetor 2013.

12. BASHKËPUNIMI RAJONAL

Zbatimi i Marrëveshjes për përfaqësimin e Kosovës në organizata dhe nisma rajonale ka qenë i kufizuar. Ka pasur pengesa të pareshtura nga pala serbe, me gjithë marrëveshjen e arritur, ndonëse në disa raste, pengesat janë hequr kur Kosova kërkoi mbështetjen e BE-së. Falë intervenimeve konstruktive nga BE-ja, Kosova është bërë anëtare e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC) më 28 shkurt 2013 dhe së fundi është bërë anëtare e Shkollës Rajonale për Administratë Publike (RESPA) më 23 nëntor 2013.

Duke pasur parasysh që qëllimi i Marrëveshjes ka qenë të hiqeshin pengesat e Serbisë për pjesëmarrjen dhe anëtarësinë e Kosovës në organizata ndërkombëtare, fakti se kërkohet intervenimi i BE-së për të hequr këto pengesa, tregon dështimin e Serbisë për të zbatuar këtë Marrëveshje.

Këtu më poshtë janë disa shembuj që ilustrojnë sfidat me të cilat Kosova përballet në procesin e arritjes së anëtarësisë, përfshirë në SEECP, MARRI, SELEC etj.

SEECP

Serbia vuri pengesa për pjesëmarrjen e Kosovës në Samitin SEECP në Ohër si dhe parandaloi futjen e kërkesës me shkrim të Kosovës në agjendën e diskutimeve ministrore të SEECP për prospektet e anëtarësit të saj në SEECP (15 maj 2013). Të njëjtën datë në Shkup, Serbia e kundërshtoi anëtarësinë në takimin e drejtorëve politikë të SEECP, në kundërshtim me Marrëveshjen për bashkëpunim rajonal dhe Marrëveshjen e Brukselit (Neni 14). Pas intervenimit nga BE-ja, autoritetet e SEECP (kryesuesi maqedonas) bëri një ftesë selektive për pjesëmarrjen e Kosovës, duke ftuar Ministrin e Punëve të Jashtme por jo edhe Presidenten e Kosovës. Si rrjedhojë, Kosova refuzoi pjesëmarrjen. Kroacia dhe Shqipëria po ashtu e refuzuan pjesëmarrjen, gjë që rezultoi me anulim të Samitit (29 maj 2013)

Kosova raportoi në BE dëshmitë e pengesave. Pas intervenimit nga BE, Kosova u ftua si “mysafir special” në takimin e nivelit të lartë të SEECP të Ministrave të Punëve të Jashtme në Nju Jork më 27 shtator dhe, sipas garancive të BE-së, do të vazhdoj të ftohet nga kryesuesi i Rumanisë në të gjitha takimet e nivelit të lartë të SEECP gjatë kryesisë së saj. Kryesia e Rumanisë ka themeluar një grup punues të atypëratyshëm (ad-hoc) për të përgatitur opsionet për një zgjidhje të përhershme për anëtarësinë e Kosovës.

MARRI

Kosova ka paraqitur një aplikacion për anëtarësim në Nismën Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI) dhe ka shenja se mund të marrë një përgjigje pozitive në maj të këtij viti. Pengesat e Serbisë kanë qenë të qarta. Ne kërkuam mbështetje nga BE për të gjetur një zgjidhje; megjithatë, anëtarësia e Kosovës në MARRI ende nuk është zgjidhur. Kosova ia doli të marrë

pjesë në takimin MARRI (Nismën Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë) të mbajtur në dhjetor.

Një situatë e ngjashme vlen për aspiratat e Kosovës për t'u bërë anëtare e Qendrës e Evropës Juglindore për Zbatim të Ligjit (SELEC). Veç kësaj, Kosova është ende duke u përballur me pengesa për t'u bërë anëtar i barabartë dhe palë nënshkruese e memorandumit të Nismës rajonale për të luftuar krimin e organizuar, një projekt që synon themelimin e bashkëpunimit mes vendeve të Ballkanit Perëndimor për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Kosova nuk u ftua në takimin rajonal të shefave të policisë, Konferencën "Shefat e policisë së rajonit të Ballkanit" të mbajtur në Beograd më 10 tetor 2012. Ajo nuk u ftua as në Konferencën "MAG-RACVIAC" e mbajtur më 9-10 tetor 2013 në Zagreb. Kosova ka marrë pjesë dhe ka luajtur rol konstruktiv në takimet e Kartës së Adriatikut (A5), Samitin presidencial në Sllovaki dhe procesin e Bërdos. Kosova ka marrë pjesë në takimin joformal të ministrave rajonal të organizuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në shtator të vitit 2013, si dhe në takimin ministror të Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore në Beograd, në nëntor 2013.

Zbatimi i marrëveshjes për bashkëpunim rajonal kërkon nga Serbia të bashkëpunojë e jo të parashtojë pengesa. Nëse përparimi në këtë fushë kushtëzohet me intervenime të BE-së dhe duke pasur parasysh organizatat e shumta rajonale, atëherë zbatimi qartazi nuk është në shtegun e duhur. Kjo kërkon që BE-ja duhet të përforcojë rolin e saj për të ndihmuar përparimin në këtë çështje.

13. ENERGJIA

Marrëveshja për energjinë është arritur më 8 shtator 2013, pas gati tri vjet negociatash. Është bërë përparim i mirë në planifikimin e zbatimit, me disa çështje ende në pritje të zgjidhjes. Palët në fillim kanë paraqitur projekt planet e tyre të veprimit të BE-ja dhe në disa takime të mbajtura deri në dhjetor në Bruksel, ato ia kanë dalë të zgjidhin dallimet e tyre lidhur me procesin e zbatimit dhe obligimet e secilës palë. Çështjet e hapura përfshijnë: qasjen në të dhëna dhe asete me qëllim të hartohen Kontratat për Shërbim për shërbimet sipas pëlqimit të arritur në marrëveshjen për energji mes KEDS dhe Newco dhe duke ndërmarrë masat e nevojshme për rrjetet e bartjes dhe shpërndarjes të cilat mund të ofrojnë Qasje Palëve të Treta efektive (TPA) për pjesën e furnizimit me rrymë të biznesit të Newco, të cilat ende nuk janë zgjidhur, për shkak të refuzimeve nga pala serbe. Veç kësaj, sapo të normalizohet operimi ilegal në veri të Kosovës, konsumatorët do të fillojnë të paguajnë për rrymën e shfrytëzuar dhe se subvencionet nga konsumatorët në jug do të ndërpriten. Kjo gjendje duhet të nxisë dhe t'i bëjë lehtësuesit e BE-së më përgjegjës për të ushtruar trysni të mjaftueshme mbi negociatorët serbë për të zbatuar marrëveshjen për energjinë sa më parë.

Po ashtu ka përparim të mirë në hartimin e marrëveshjes kornizë për bashkëpunim mes operatorëve të transmissiionit të Kosovës dhe Serbisë, respektivisht KOSTT dhe EMS, të cilat më në fund përfundojnë shkëlqen nga Serbia të Traktatit të Athinës në lidhje me Kosovën. Pjesa teknike është ende e pazgjidhur pasi që pala kosovare ka refuzuar formatin e nënshkrimit. Qëndrimi i Kosovës është se palët nënshkruese duhet të përfshijnë tri palë, Kosovën, Serbinë dhe BE-në, në bazë të praktikës që po aplikohet në dialogun e Brukselit. Propozimi që ishte vënë në tavolinë për marrëveshje të ndërsjellë me palë nënshkruese KOSTT dhe EMS, pa përmendur emrat e shteteve, u refuzua nga pala kosovare. Argumenti i palës kosovare ishte se ne nuk jemi të gatshëm të nënshkruajmë kurrfarë marrëveshjeje të ndërsjellë me Serbinë, madje as në nivel të kompanive publike, derisa Serbia të mos heqë nga kushtetuta e saj pretendimin se Kosova është pjesë e Serbisë.

14. TELEKOMUNIKACIONI

Për telekomunikacionin, marrëveshja u arrit më 8 shtator 2013. Ngjashëm si në rastin e çështjeve për energjinë, negociatat zgjatën për afër tri vjet dhe marrëveshja u konfirmua në takimin e Kryeministrave dhe Përfaqësueses së Lartë të BE-së Ashton. Ka pasur vonesa në vazhdimin e bisedave për zbatimin, mund të duket se për shkak të përqendrimit të BE-së në çështje tjera më urgjente të dialogut.

Bisedat për zbatimin e marrëveshjes filluan më 15 janar 2014, kur palët diskutuan planin e akcionit. Përparim i mirë është shënuar në dizajnimin e projekt planit, përfshirë veprime dhe afate kohore të caktuara. Në periudhën e ardhshme, ky plan veprimi duhet të avancohet edhe më tej dhe për të duhet të pajtohen palët.

15. REGJISTRI CIVIL

Marrëveshja për Regjistrin Civil u arrit më 2 korrik 2011. Zbatimi i saj filloi më 6 dhjetor 2011 dhe në përputhje me planin e veprimit, ajo duhej të zbatohet në një periudhë prej 9 muajsh. Ndonëse ritmi i zbatimit nuk ka qenë i kënaqshëm, megjithatë është bërë përparim substancial deri më tash. Nga 12.036 libra të regjistrin civil që janë marrë nga Serbia gjatë luftës 10.913 libra të regjistrin civil të skenuar i janë dorëzuar Kosovës. Sipas marrëveshjes, librat e skenuar /kopjuar nga ekipe trepalëshe në Nish (Serbi) janë certifikuar nga EULEX-i dhe pastaj u janë dorëzuar institucioneve të Kosovës. Dorëzimi i librave të mbetur është caktuar të kryhet në fillim të vitit 2014. BE-ja e ka financuar këtë projekt dhe asistencë teknike është ofruar nga DRC, si partner implementues i kontraktuar nga BE/EUSR.

16. KADASTRA

Marrëveshje për Kadastrën (2 Shtator 2011) bën thirrje për kthimin në Kosovë të dokumenteve kadastrale të marra nga Serbia gjatë luftës. Ekzistojnë rreth 12 milion harta/dokumente kadastrale që duhet të kthehen. Për planin e zbatimit u arrit marrëveshja më 21 dhjetor 2011, por që atëherë nuk ka pasur përparim në zbatimin e tij, përveç punës përgatitore. Marrëveshja kërkonte nga pala e Kosovës miratimin e ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (KPCVA) dhe themelimin e saj. Paralelisht, ajo kërkonte që pala serbe të kryente skanimin e dokumenteve kadastrale që do të kthehen në Kosovë përmes EUSR. Pala e Kosovës ende nuk ia ka dalë të miratojë ligjin në Parlament, me gjithë punën e paseshtur në këtë drejtim.

Projektligji për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (KACVP), u miratua me një vendim qeveritar më 11 dhjetor 2011, me vendimin e qeverisë me numër 01/100.

Më 19 mars 2013, Kuvendi i Kosovës miratoi projektligjin pas leximit të parë. Pas leximit të dytë nga Kuvendi i Kosovës, projektligji më 19 korrik 2013 u tërhoq nga procedura parlamentare nga Qeveria me qëllim që të integrohen komentet e komisioneve të caktuara parlamentare, me qëllim që të arrihej mbështetja për miratimin e tij nga Kuvendi,.

Nga gushti i vitit 2013 deri më tash, grupi punues i Kosovës, në bashkëpunim me EUSR ka përgatitur një projektligj të ri për KACVP. Vështirësitë në kalimin e këtij ligji në Parlament dalin nga mospërputhja mes rolit të zyrtarëve të zyrtarëve të paraparë në të dhe ndryshimeve kushtetuese të miratuara për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare në vitin 2012.

Më 27 dhjetor 2013, Qeveria e Kosovës miratoi një projektligj të modifikuar të cilin e procedoi në parlament për ratifikim.

Në anën tjetër, pala serbe ka bërë pak përparim për skanimin e dokumenteve kadastrale. Në bazë të informatave të siguruar nga EUSR, pala serbe deri më tash ka skenuar rreth 37,000 copë (0.002 %) nga 12 milion harta/dokumente kadastrale dhe ata planifikojnë t'i dorëzojnë te EUSR në Kosovë më 24 janar 2014.

17. DIPLOMAT

Nuk ka pasur përparim në lidhje me pranimin e diplomave të Kosovës nga pala serbe. Marrëveshja për Pranim të Ndërsjellë të Diplomave Universitare përmes certifikimit nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane (EUA) është arritur më 2 korrik 2011 dhe plotësuar/përfunduar më 21 nëntor 2011. Zbatimi i saj filloi në shkurt të vitit 2012. Deri më sot janë certifikuar 279 aplikacione nga Asociacioni e Universiteteve Evropiane (EUA).

Në bazë të një raporti të prezantuar nga partneri implementues SPARK, deri më sot, asnjë diplomë e certifikuar nga EUA nuk është nostrifikuar ose asnjë letër zyrtare e pranimit nuk është lëshuar nga ndonjë institucion i Serbisë.

Kontrata dyvjeçare me partnerin implementues SPARK është para skadimit, ajo pritet të skadojë në gjysmën e parë të vitit 2014, andaj ekipi i EUSR, që e ka mbikëqyrur projektin ka filluar diskutimet me partnerin implementues për fazat tjera.

PËRFUNDIMI

Ky raport ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të zbatimit të të gjitha marrëveshjeve të Brukselit gjatë vitit 2013. Ai demonstroi se përparimi i konsiderueshëm është arritur në përgjithësi në disa çështje të rëndësishme, ndërsa në disa të tjera, janë shënuar nivele të ndryshme të përparimit. Po ashtu ka çështje/fusha ku zbatimi nuk ka filluar ende. Kërkohej punë efektive në të ardhmen për të përmbushur caqet e këtij dialogu të rëndësishëm për paqe mes dy shteteve që aspirojnë BE-në, Kosovës dhe Serbisë, të cilët nëse përmbushen me sukses dhe në mënyrë të efektshme, mund të shërbejnë si model i mirë për çështjet e tjera të hapura në marrëdhëniet mes vendeve në rajon dhe më tej.

Lista e shkurtesave

PKK- Pikë Kalim kufitar
KQZ - Komisioni Qendror Zgjedhor i Kosovës
CEFTA - Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë
MC - Mbrojtja civile
EEAS - Shërbimi evropian për veprim të jashtëm
EMS - Sistemi serb i transmisionit të rrymës dhe operatori i tregut
BE- Bashkimi Evropian
EUA - Shoqata e Universiteteve Evropiane
EULEX - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
EUSR - Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian
PL - Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri
IBM - Menaxhim i integruar i kufirit
IG - Grup implementues
KEDS - Distribucioni dhe furnizimi me rrymë i Kosovës
KGJK - Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KOSTT - Sistemi kosovar i transmisionit të rrymës dhe operatori i tregut KP - Kosovo Police
KPK - Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPCVA - Agjencia kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës
MARRI - Nisma rajonale për migrim, azil dhe refugjatë
MLA - Ndihma e ndërsjellë juridike
MAPL- Ministria për Administrim të Pushtetit Lokal e Kosovës
MUP - Ministria e Brendshme e Serbisë
OSBE -Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KM - kryeministrat
RCC - Këshilli Rajonal i Bashkëpunimit
RESPA - Shkolla Rajonale për Administratë Publike
SEECF - Procesi për Bashkëpunim i Evropës Juglindore
SELEC - Qendra e Evropës Juglindore për zbatim të ligjit
SIM - Moduli i identitetit të abonuesit për një telefon mobil